



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 84

Prishtinë, më 25.04.2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Rrezarta Krasniqi dhe Elmi Reçica.

Stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Fjolla Ujkani, zëvendëskryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Votimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekste shkollore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Votimi i Projektligjit nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Votimi i Projektligjit nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Votimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekste shkollore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Zëvendëskryetarja: Siç e dini, në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtuar projektligjet të cilat i kemi sot për votim, por në mungesë të vendimmarrjes në mbledhjen e kaluar sot i kemi përsëri në rend dite për votim.

Pas votimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se, në votim morën pjesë katër deputetë, andaj, konstatoi se nuk ka vendimmarrje.

3. Votimi i Projektligjit nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Zëvendëskryetarja: Këtë projektligj e kemi shqyrtuar në mbledhjen e kaluar, por në mungesë të vendimmarrjes në mbledhjen e kaluar, sot e kemi përsëri në rend dite për votim.

Pas votimit, zëvendëskryetarja konstatoi se, në votim morën pjesë katër deputetë andaj, konstatoi se nuk ka vendimmarrje.

4. Votimi i Projektligjit nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Zëvendëskryetarja: Këtë projektligj e kemi shqyrtuar në mbledhjen e kaluar, por në mungesë të vendim marrjes në mbledhjen e kaluar sot e kemi përsëri në rend dite për votim.

Driton Hyseni: Apeloj tek deputetet e opozitës që janë prezentë në mbledhje, që të marrin pjesë në votim, sepse kështu e dërgoni besimin e qytetarëve në drejtimin që ata presin dhe kështu do të përmbushim mandatin që kemi si deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Blerta Deliu Kodra: Kësaj Qeverie i ka humbur komplet kredibilitetit dhe këtë tashmë e bazojmë edhe në raportet shumë të rëndësishme dhe kredibile, si ai i Departamentit Amerikanë të Shtetit dhe ai i Freedom House, të cilat konfirmojnë edhe një herë për një Qeveri e cila e ka humbur kredibilitetit dhe që ka probleme shumë të mëdha, qoftë në demokratizim, qoftë në korrupsion serioz elitar, probleme më të drejtat e njeriut, gjyqësor dhe cenim të institucioneve të drejtësisë. Në rrethana të tilla, ku nuk ka asnjë deklaram të Qeverisë, madje ka zyrtarë të kësaj qeverie që gjithë këtë kohë kanë qenë të zënë me fushatën zgjedhore në një shtet fqinjë dhe nuk i kanë kryer detyrat e tyre qeveritare. Është e pakuptimtë që ne sot të merremi me votim të këtyre projektligjeve, e të cilat projektligje nuk kanë përfshirë asnjëherë asnjë propozim e argument të zërit opozitar.

Prandaj, konsideroj se vendi duhet t'i hap rrugë sa më parë zgjedhjeve të reja, sepse pushteti ka qenë i zënë tash e dy javë me agjenda të tjera dhe ka dështuar në agjendën legjislative.

Duke e parë se çfarë rruge ka marrë Kosova me këtë Qeveri, është e pa kuptim pjesëmarrja në çfarëdo votimi.

Driton Hyseni: Raporteve të cilave ju referuat, nëse i lexoni me kujdes do të shihni se ato raporte e evidentojnë që Qeveria aktuale ka marrë hapa konkret dhe shumë serioz në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në vend. Po ashtu, këto raporte i referohen shumë periudhës së kaluar se si kanë vepruar liderët politikë të lidhur me elementet kriminal në vendin tonë, prandaj, nuk e shoh të arsyeshme që ju duke iu referuar këtyre raporteve të vini në Komision për Integritim Evropian të jeni prezent dhe të mos e jepni kontributin e juaj si deputetë sepse ligjet të cilat janë për miratim, janë në dobi të qytetarëve tanë. Nuk mund të jemi në pengë të raporteve ndërkombëtare për mosvotim të projektligjeve, e aq më pak të projektligjeve të cilat janë në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe me të gjithë parametrat evropian.

Blerta Deliu- Kodra: PDK-ja ka qëndrim të qartë për të mos marrë pjesë në votim, po ashtu, kemi kërkuar zgjedhje të reja për shkak të mosfunksionimit të institucioneve dhe humbjes së legjitimitetit të kësaj Qeverie. Ku i keni deputetët e juaj, ku janë ata për t'i votuar ato ligje që qenkan shumë të rëndësishme sot?

Sa i përket punës së qeverive të kaluara, është narrativ i VETVENDOSJE-s që për çdo parregullsi që e ka sot Qeveria me vendos fajin tek qeverisjet e kaluara. Në Qeverinë e kaluar këto raporte kanë folur për një nivel të korrupsionit endemik, sot, raporti flet për nivel serioz të korrupsionit qeveritar.

Kryeministri Kurti sa ishte në opozitë, thoshte se një vend i cili është pjesërisht i lirë, siç është rasti i Kosovës, qytetarët kanë legjitimitet për të kërkuar azil politik. Sot, gjendja në të cilën ne jemi, jo vetëm aferat korruptive, por edhe përpjekja që t'i mbrojnë personat që janë të përfshirë në këto afere, mosndëshkimi i tyre, ju japin legjitimitet shumë të madh që të ikin nga ky vend. Prandaj, se kuptoj se si nuk mund t'i merrni në konsideratë raportet kredibile ndërkombëtare të cilat flasin për cenim të drejtave të njeriut, shkelje të demokracisë, sulme të drejtpërdrejta në institucionet e drejtësisë, qeveritarë që linçojnë, bulëzojnë gazetarë dhe në fund vini dhe na kërkonin ne që të marrim pjesë në votim, se qenka në interes të qytetarëve të Kosovës. Janë shtatë ligje të kësaj Qeverie, të cilat janë shpallur jokushtetues, nuk janë marrë parasysh asnjëherë propozimet dhe vërejtjet e shoqërisë civile e as të opozitës. Përkundër të gjitha këtyre, ne si deputetë opozitarë jemi angazhuar dhe në të gjitha takimet që kemi pas kemi kërkuar largim të masave dhe kemi punuar e angazhuar që të kalojmë të gjithë filtrat, për anëtarësim në Këshill të Evropës, por, kjo nuk është rruga të cilën duhet ndjekur, duke injoruar tash edhe raportet ndërkombëtare, të cilat janë shumë kredibile, e ju vazhdoni të mbani gishtat te qeveritë e kaluara. Duhet që një herë e mirë të merrni përgjegjësi sepse qytetari ka votuar për juve.

Driton Hyseni: Unë ju referova raportit të nxjerrë nga Departamenti i Shtetit që i referohet pikërisht çështjes që ju ju referuat, pra, krimin të organizuar dhe korrupsionit. Ju e dini që ka vetëm një rast të vetëm që i përmendet emri i një ministrit me emrin e tij dhe ai është ministër i komunitetit, në asnjë rast nuk e ke asnjë emër që përmendet nga Qeveria aktuale, përveç nivelit të hetimeve që bëhen. Unë ju referova raportit në mënyrën më korrekte të mundshme sepse aty e gjen shumë qartë këtë çështje si është trajtuar. Unë mendoj që lidhja që i bëhet me të kaluarën, është lidhje që qëndron sepse të gjithë kemi jetuar edhe rrethanat në të cilat ka qenë edhe Kosova më herët dhe e kemi të qartë atë pjesë. Unë lutjen që e bëra në fillim, ju tani tentuat ta arsyetoni me raporte ndërkombëtare, të cilat nuk qenkan në favor të Kosovës. Por, mos harroni se në ato raporte ka shumë vlerësime pozitive për shumë mekanizma shtetërorë nga puna që bëhet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në ato raporte vërtet thuhet që janë cenuar gazetarët, por në masë të madhe thuhet për cenimin që u është bërë në protestat në veri të vendit. Në asnjë

rrethanë nuk kemi parë tendencë të Qeverisë për të ndërhyrë në gjyqësor, nëse janë dhënë opinione në lidhje me mos punën efektive të gjyqësorit, ata e dokumentojnë edhe raportet qoftë i Freedom Hous, qoftë i Departamentit Amerikan të Shtetit, qoftë raportet e Bashkimit Evropian, që tregojnë për një mosefikasitet në sistemin e drejtësisë, për tejzgjatje të zgjidhjes së rasteve në procedurë gjyqësore. Nuk besoj se është ndërhyrje në gjyqësor, nëse ne si deputet apo ndonjë ministër diskuton e kërkon që sistemi i drejtësisë të jetë më efikas në punën e vet me zgjidhjen e rasteve në procedura gjyqësore, por, konsideroj se paraqet vullnetin e forcave politike për të pasur një sistem të drejtësisë më efikas.

Blerta Deliu-Kodra: Pesë ministra dhe dy zëvendësministra të kësaj Qeverie përmenden në raport. Në mesin e dy zëvendësministrave përmendet edhe mosdeklarimi i pasurisë së Liza Gashit në afatet kohore. Kemi dëgjuar disa herë Kryeministrin Kurti, se cili Kryeprokuror nuk i pëlqen atij, e cili nuk i pëlqen Vjosës, e cili nuk është i pranueshëm për Glaukun. Çka duhet me ndodh më shumë se sa kur Kryeministri i vendit flet se cili person është i pranueshëm e cili jo për një institucion, i cili do të duhej të ishte i pavarur?

Kemi dëgjuar disa herë Kryeministrin duke marrë në mbrojtje Nagip Krasniqin, e duke i sulmuar institucionet e drejtësisë të cilët kanë zell për t'u marrë me rastin e tij me qëllim luftimin e korrupsionit, ndërkohë që Bordi dje e ka shkarkuar të njëjtin.

Prandaj, nuk mund t'iu ikim raporteve, sepse, argumentet, faktet flasin për një nivel të lartë të korrupsionit dhe cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Time Kadrijaj: Që nga ora 10:00, kur kemi ardhur, tani është ora 10:30 dhe ende nuk i keni deputetët e juaj këtu, kjo flet se me sa seriozitet e keni marrë punën e Komisionit dhe miratimin e ligjeve. Kërkohet përkrahje për marrëveshjet ndërkombëtare që kërkohen dy të tretat e votave, vota të cilat nuk i keni. Përkundër përkrahjes së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që e keni për miratimin e marrëveshjeve, nuk mundeni të kërkon mbështetje përderisa as ju vet nuk jeni serioz në këto tema e mbledhje.

Pas votimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se, në votim morën pjesë katër deputetë, andaj, konstatoi se nuk ka vendimmarrje.

5. Të ndryshme.

a) *Organizimi i tryezës së Komisionit*

Zëvendëskryetarja: Siç jeni njoftuar edhe në mbledhjen e kaluar, duke parë rëndësinë e Procesit të Berlinit, po ashtu, duke e ditur që Kosova vitin e ardhshëm do të kryesoj CEFTA-n, propozoj që si Komision të organizojmë një tryezë diskutimi, ku do të diskutohet mbi rëndësinë e Procesit të Berlinit dhe CEFTA-n.

Si datë për organizim propozoj fundin e muajit maj, më 22 maj 2024, dhe në ndërkohë do njoftoheni për të gjitha detajet e kësaj tryeze.

Agon Batusha: Propozoj që në tryeza të përfshihen në prezantime në panele edhe deputetët anëtarë që nuk janë kryetarë e nënkryetarë të komisioneve. Kjo për arsye se në tryezat e kaluara

gjithë kohën kanë qenë të përfshirë në panele vetëm Kryetarët dhe nënkryetarët, ndërsa anëtarët e komisionit po mbesin të papërfshirë.

Driton Hyseni: Propozoj që të dërgohet një draft nga ana e stafit mbështetës, në mënyrë që anëtarët e Komisionit të dërgojnë propozimet e tyre në mënyrë që të ketë gjithëpërfshirje dhe organizim më të mirë. Duke qenë se në Bashkimin Evropian do të kenë zgjedhje, konsideroj që do të kemi vështirë prezencën e shumë pjesëmarrësve dhe eurodeputeteve në këtë tryezë gjatë kësaj periudhe.

Pas këtyre propozimeve anëtarët e Komisionit me gjashtë vota “për” nxorën këtë:

Vendim

Për organizim të një tryeze diskutimi për datën 22 maj 2024.

Zëvendëskryetarja: Tashmë i kemi gjashtë deputet të cilët do të marrin pjesë në votim, prandaj, po përsëris votimin e pikave të cilat veç se i kishim më herët në votim.

Pas votimit, zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota “për” nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-207 për tekste shkollore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian, andaj rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pas votimit, zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota “për” nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, andaj rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pas votimit, zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota “për” nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian, andaj rekomandohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Fjolla Ujkani,
Zëvendëskryetare e Komisionit
